



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



PËR:

1. Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-
2. Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave
-Zyrës Ligjore-

I	Data	26.03/20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01 N1. 60/01-8927/20				

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së I-r(Parë) e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 26.03.2020.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e I-r (Parë) e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 26.03.2020 dhe atë:

1. Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga pandemia COVID -19.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.400/01-8928/20
Kaçanik, 26.03.2020

Bazuar ne Vendimet e Qeverisë të Republikës së Kosovës për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19, Kërkesës së Shtabit Emergjent Komunal për parandalimin e Pandemisë COVID 19, neneve 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (b) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008) të Ligjit Nr.07/L-001 mbi ndarjet buxhetore të vitit 2020, të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 dhe 61 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.400/01-8928/20 prej datës 25.03.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 26 Mars 2020 mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19

1. Duke pasur për bazë situatën emergjente dhe gjendjen ekonomike të banoreve të Komunës së Kaçanikut, lejohen mjete financiare nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në shumën prej 100,000.00 € (Njëqindmijë euro). Shuma e mjeteve financiare për këtë qëllim do të sigurohet nga Nën programet në vijim: Nën programi 16028 shuma 20,000.00 € (njëzetmijë euro) Nën programi 16328 shuma 30,000.00 € (tridhjetmijë euro) dhe Nën programi 18028 shuma prej 50,000.00 € (pesëdhjetmijë euro). Duke pasur për bazë situatën emergjente dhe gjendjen ekonomike të banoreve të Komunës së Kaçanikut
2. Shuma e mjeteve buxhetore të lejuara si në pikën 1. të këtij vendimi do të shfrytëzohet për sigurimin e artikujve (pakove) ushqimore, higjienikë për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, dezinfektimin e hapësirave publike, furnizimin me mjete mbrojtëse nga COVID 19, dhe mbulimin e nevojave tjera që dalin si rezultat i parandalimit të kësaj sëmundjeje.
3. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 1000-8928/20
Kaçanik; 25.03.2020

Bazuar ne Vendimet e Qeverisë të Republikës së Kosovës për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19, kërkesës së Shtabit Emergjent Komunal për parandalimin e Pandemisë COVID 19, neneve 12.2 pika d, nenit 40 pika c, nenit 58 të Ligjit për vetqeverisje lokale 03/L-040, Kryetari i Komunës për seancën e jashtëzakonshme të caktuar nga Kuvendi Komunal për datën: 26.03.2020 propozon këtë:

Propozim- Vendim

Për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19

1. Duke pasur për bazë situatën emergjente dhe gjendjen ekonomike të banoreve të Komunës së Kaçanikut, lejohen mjete financiare nga kategoria e Mallrave dhe Sherbimeve në shumën prej 100,000.00 euro. Shuma e mjeteve financiare për këtë qëllim do të sigurohet nga Nenprogramet në vijim: Nenprogrami 16028 shuma 20,000.00 euro, Nenprogrami 16328 shuma 30,000.00 euro dhe Nenprogrami 18028 shuma prej 50,000.00 euro.
2. Kjo shumë do të shfrytëzohet për sigurimin e artikujve (pakove) ushqimore, higjienike për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, dezinfektimin e hapsirave publike, furnizimin me mjete mbrojtëse nga COVID 19, dhe mbulimin e nevojave tjera që dalin si rezultat i parandalimit të kësaj sëmundjeje.
3. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
4. Vendimi hynë në fuqi pas verifikimit të ligjshmerisë nga MAPL dhe Ministria e Financave dhe Transfereve.



Kryetari i Komunës:

Besim Ilazi